



Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 45, paragrafi 45.2 i Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, dhe të nenit 4, pika 4.3 e Rregullores për procedurën e themelimit, përbërjes dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunën e Prishtinës, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa të Kryeqytetit,

th ë r r e t

mbledhjen e **dhjetë** të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **20.12.2023** dhe do të fillojë në orën **13:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën nr. 37 (kati II) të Komunës së Prishtinës.

Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së jashtëzakonshme dhe mbledhjes së nëntë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Rrahman Haradinit dhe Shaban Kongjelit ;
3. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Skender (Habit) Krasniqit;
4. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Shyhrete (Fazli) Ramës dhe Flamur (Fehmi) Ramës;
5. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Asllan (Bahtir) Demollit, Albert (Bajram) Mavriqit, Remzush (Bajram) Mavriqit, Hysen (Bajram) Mavriqit dhe Arben (Bajram) Mavriqit;
6. Propozim-rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në Komunën e Prishtinës, 01. nr. 110-1203, i dt. 16.06.2010 ;

7. Propozim-vendimi për lënie në shqyrtim publik të projekt dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm "Kalabria", 2023-2031 në Prishtinë;
8. Propozim-vendimi për fillimin e revidimit të Planit Rregullues të Hollësishëm "Zona ekonomike", në Prishtinë;
9. Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale;
10. Projekt-rregullorja për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës;
11. Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së SHFM „Don Bosko”, Prishtinë;
12. Propozim-vendimi për nismën e bashkëpunimit në mes Kryeqytetit Prishtina dhe Kryeqytetit Kuwait city;
13. Propozim-vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2024;
14. Të ndryshme.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-060/07-231073/23, më 11.12.2023

KRYESUESI I KOMITETIT

Pëllumb Bajcinovci

